

RAPORTI I NJSBC
VITI AKADEMIK 2021-2022
KOLEGJI UNIVERSITAR “BEDËR

1. TË DHËNA MBI PROGRAMET E STUDIMIT	3
1.1 Programet e studimit të ofruara dhe programet e studimit në proces licencimi	3
1.2 Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit dhe lidhja me tregun e punës	5
2. TË DHËNA MBI STUDENTËT	7
2.1 Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar	7
Bachelor në Informatikë Ekonomike	7
Programi Profesional Programim në Web	7
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	8
Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike	8
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Edukim Fetar	8
Master Profesional në Komunikim Marketingu	8
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	9
Master Profesional në Komunikim Marketingu	9
2.2 Numri i studentëve që ndjekin programet që përbëjnë përparësi kombëtare	10
2.3 Numri i studentëve të shkëlqyer.	10
Bachelor në Informatikë Ekonomike	10
Programi Profesional Programim në Web	10
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	11
Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike	11
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Dialogu Ndërfetar	11
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Edukim Fetar	11
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Liderhipi Fetar	11
Master Profesional në Komunikim Marketingu	11
2.4 Numri i studentëve të çregjistruar ose të transferuar.	12
Bachelor në Informatikë Ekonomike	12
Programi Profesional Programim në Web	12
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	13
Master Profesional në Komunikim Marketingu	13
3. REALIZIMI I MISIONIT, QËLLIMEVE, OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES DHE KËRKIMIT SHKENCOR	14
3.1 INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCION APO MBI PROJEKTET QË MERR PJESE SI PALË AKTIVE	19

4. SIGURIMI I CILESISE	23
4.1 PROJEKTI BOLOGNA HUB PEER SUPPORT	23
4.2 TRAJNIME	32
4.3 AKREDITIME	35
1. Vlerësim i brendshëm dhe i jashtëm	35
2. Aplikim për akreditim programesh	35
4.4 ANKETA	37
1. Anketat e studentit për vlerësimin e pedagogut dhe lëndës	37
2. Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik	37
3. Anketë vlerësimi e studentit për institucionin dhe shërbimet që ai ofron	37
4. Anketë vlerësimi e stafit akademik për institucionin	41
5. Anketë vlerësimi e stafit administrativ për institucionin	46

1. TË DHËNA MBI PROGRAMET E STUDIMIT

1.1 Programet e studimit të ofruara dhe programet e studimit në proces licencimi

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.04.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe me urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës nr. 534 dt: 27.10.2011, nr. 18 dt.: 19.01.2012, nr. 10 dt.: 16.1.2012, nr. 218 dt.: 28.05.2012, nr. 330 dt.: 07.08.2012, nr. 404 dt.: 12.07.2018 dhe nr.426 dt.: 18.07.2018 janë hapur këto programe studimi me kohë të plotë:

Ciklit i parë të studimeve

“Bachelor” në:

- Drejtësi (i riorganizuar)
- Shkenca Kompjuterike
- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Komunikimi
- Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze
- Shkenca Islame
- Programim në Web (profesional)
- Multimedia dhe Dizajn Grafik (profesional)
- Financë Kontabilitet (program i ri)
- Administrim Biznes (program i ri)

Cikli i dytë i studimeve:

“Master profesional” në:

Gjuhë dhe Gjuhë dhe Letërsi Angleze

- Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë;
- Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët

Komunikim marketingu

“Master i shkencave” në:

Drejtësi

- Profili: E drejtë penale
- Profili: E drejtë ndërkombëtare;

Shkenca komunikimi:

- Profili: Marrëdhënie me publikun
- Profili: Gazetari;

Shkenca Islame

- Studime religjioze
- Dialog
- Edukim Fetar
- Lidërsip Fetar

Shkenca Kompjuterike

1.2 Përshatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit dhe lidhja me tregun e punës

Programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “Bedër” janë në përputhje të plotë si me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun evropian.

Kurrikulat bashkëkohore të Kolegjit Universitar “Bedër” synojnë të përgatisin:

Jurist\specialist në institucionet e administratës publike (qendrore/vendore); jurist\specialist në institucione ndërkombëtare; jurist\specialist\konsulent ligjor në sektorin privat; asistent avokat\asistent noter si dhe kualifikim për pjesëmarrje në provimin e avokatisë; asistent kërkimor\mësimor pranë IAL.

Specialistë të kualifikuar për administratën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH) në qendër dhe bazë, si dhe mësues për institucionet e arsimit 9-vjeçar e të mesëm në varësi të KMSH-së.

Specialistë dhe profesionistë të shkencave të komunikimit, të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit dhe të marrëdhënieve publike apo dhe në fusha të ngjashme me to, të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale që shpejton në kapjen dhe zbatimin e teknologjive moderne, që kanë përfshirë fushën e komunikimit e të medias.

Mundësitë e punësimit pas diplomimit përfshijnë aftësi pedagogjike drejtuese për të aplikuar në institucione të ndryshme. Studentët do të jenë të aftë të punësohen si edukatore dhe mësues. Gjithashtu ata do të fitojnë aftësi të ndryshme në drejtimin pedagogjik dhe psikologjik, të cilat mund t'i zbatojnë në institucione të ndryshme private ose publike.

Pas diplomimit, studentët mund të vazhdojnë studimet e tyre të doktoraturës, ose studime pasuniversitare në Shqipëri ose jashtë vendit. Ata gjithashtu mund të bëhen lektorë në universitete, koordinatorë konferencash, projektsh etj. Ky program i mundëson studentët të pajisen me aftësi dhe njohuri të ndryshme. Ai gjithashtu i mëson ata si të lehtësojnë marrëdhëniet personale dhe ndërpersonale në përgjithësi. Studentët do të kenë gjithashtu mundësi të punësohen në institucione të ndryshme edukimi, të cilat mund të përmbajnë menaxhim, planifikim apo zhvillim kurrikule.

Studenti pasi të ketë kryer specializimet përkatëse mund të punojë si përkthyes ose editor në media dhe shtëpi botuese, gjithashtu mund të punojë edhe si kërkues shkencor në fushën e dokumentacionit në osmanisht.

Studenti pasi të ketë kryer specializimet përkatëse mund të punojë si mësues gjuhe dhe letërsie në arsimin fillor, gjithashtu në shkollë të mesme dhe mësues në qendra të ndryshme kursesh. Studenti mund të komunikojë rrjedhshëm në nivele akademike si me shkrim ashtu edhe me gojë me folësit amtarë dhe joamtarë të gjuhës turke; të përkthejë tekste të ndryshme, të shpalosë lehtësi komunikimi mes palëve turqishtfolëse dhe joturqishtfolëse.

2. TË DHËNA MBI STUDENTËT

2.1 Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar

Të regjistruar “BACHELOR”	
2021-2022	
Fakulteti Teknologjisë dhe Biznesit	82
Bachelor në Shkenca Kompjuterike	33
Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	19
Bachelor në Informatikë Ekonomike	16
Programi Profesional Programim në Web	14
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	100
Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave në Drejtësi"	14
Bachelor në Shkenca Islame	23
Bachelor në Shkenca Komunikimi	14
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	20
Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	15
“Programi Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”	14
Totali	182
Të regjistruar “MASTER”	
2021-2022	
Fakulteti Teknologjisë dhe Biznesit	12
Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike	12
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	104
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Penale	20
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Ndërkombëtare	7
Master i Shkencave në Shkenca e Komunikimit / Profili Gazetari	2
Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi / Profili Marrëdhënie me Publikun	25

Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Edukim Fetar	8
Master Profesional në Komunikim Marketingu	13
Master i Shkencave në Shkenca Islame	7
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	9
Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze Arsimit të Mesëm të Lartë dhe Arsimit të Mesëm të Ulët	13
Totali	116

Të diplomuar “BACHELOR”	
2021-2022	
Fakulteti Teknologjisë dhe Biznesit	23
Bachelor në Shkenca Kompjuterike	13
Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	10
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	83
Bachelor në Drejtësi	29
Bachelor në Shkenca Islame	7
Bachelor në Shkenca Komunikimi	13
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	11
Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	16
“Programi Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”	7
Totali	106
Të diplomuar “MASTER”	
2021-2022	
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	93
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Penale	12
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Ndërkombëtare	7

Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit / Profili Gazetari	1
Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi / Profili Marrëdhënie me Publikun	17
Master i Shkencave në Shkencat Moderne Islame	4
Master Profesional në Komunikim Marketingu	13
Master i Shkencave në Shkencat Themelore Islame	5
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	3
Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze Arsimi i Mesëm i Lartë dhe Arsimi i Mesëm i Ulët	31
Totali	93

2.2 Numri i studentëve që ndjekin programet që përbëjnë përparësi kombëtare

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë regjistruar në programet me prioritet kombëtar gjithsej 15 studentë në programin “Bachelor” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze si dhe 22 studentë në programet “Master”, nga ku 9 prej tyre janë në programin “Master i shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe 13 studentë në programin Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze Arsimi i Mesëm i Lartë dhe Arsimi i Mesëm i Ulët.

2.3 Numri i studentëve të shkëlqyer.

(Studentë me mesataren 4 të cilet quhen studentë të shkëlqyer)

Të shkëlqyer “BACHELOR”	
2021-2022	
Fakulteti Teknologjisë dhe Biznesit	0
Bachelor në Shkenca Kompjuterike	-
Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	-
Bachelor në “Financë-Kontabilitet”	-
Bachelor në Informatikë Ekonomike	-
Programi Profesional Programim në Web	-
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	4
Bachelor në Drejtësi	1
Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave në Drejtësi"	-
Bachelor në Shkenca Islame	1
Bachelor në Shkenca Komunikimi	-
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	-
Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	2
“Programi Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”	-
Totali	4
Të shkëlqyer “MASTER”	
2021-2022	
Fakulteti Teknologjisë dhe Biznesit	0
Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike	-
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	9

Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Penale	-
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Ndërkombëtare	1
Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit / Profili Gazetari	-
Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi / Profili Marrëdhënie me Publikun	1
Master i Shkencave në Shkencat Moderne Islame	-
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Dialogu Ndërfetar	-
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Edukim Fetar	-
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Liderhipi Fetar	-
Master Profesional në Komunikim Marketingu	-
Master i Shkencave në Shkencat Themelore Islame	1
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	2
Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze Arsimit të Mesëm të Lartë dhe Arsimit të Mesëm të Ulët	3
Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze Arsimit të Mesëm të Lartë	1
Totali	9

2.4 Numri i studentëve të çregjistruar ose të transferuar.

Çregjistrimet dhe trasferimet “BACHELOR” 2021-2022	
Fakulteti Teknologjisë dhe Biznesit	8
Bachelor në Shkenca Kompjuterike	3
Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	2
Bachelor në Informatikë Ekonomike	1
Programi Profesional Programim në Web	2
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	32
Bachelor në Drejtësi	1
Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave në Drejtësi"	2
Bachelor në Shkenca Islame	12
Bachelor në Shkenca Komunikimi	2
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	5
Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	5
“Programi Profesional në Multimedia dhe Dizajn Grafik”	5

Totali	40
Cregjistrimet dhe transferimet “MASTER”	
2021-2022	
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë	35
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Penale	3
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejtë Ndërkombëtare	3
Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit / Profili Gazetari	1
Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi / Profili Marrëdhënie me Publikun	4
Master i Shkencave në Shkencat Moderne Islame	2
Master i Shkencave në Shkenca Islame	2
Master Profesional në Komunikim Marketingu	1
Master i Shkencave në Shkencat Themelore Islame	3
Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm	9
Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze Arsimi i Mesëm i Lartë dhe Arsimi i Mesëm i Ulët	4
Master i Shkencave në Studime Religjioze / Profili Edukim Fetar	3
Totali	35

3. REALIZIMI I MISIONIT, QËLLIMEVE, OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Misioni i Kolegjit Universitar “Bedër”, i cili nisi veprimtarinë në vitin akademik 2011-2012, është përgatitja e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve në shërbim të shoqërisë.

Misioni i sipërpërmendur është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (shprehur në nenin 1 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”) me standardet ndërkombëtare, Kartën e Bolonjës, si dhe me veçantitë e risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë.

Në kuadër të përmbushjes së misionit dhe rolit që institucionet e arsimit të lartë, në tërësinë e tyre, kanë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin, Kolegji Universitar “Bedër”, gjatë vitit akademik 2020-2021, realizoi aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, konferencave ndërkombëtare në disa fusha, organizim të aktiviteteve të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me pjesëmarrjen aktive të studentëve në nisma të ndërmarra nga vet ata, në bashkëpunim me institucione të ndryshme në dobi të shoqërisë. Në këtë vit akademik, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, pjesa më e madhe e aktiviteteve janë zhvilluar virtualisht.

Kolegji Universitar “Bedër”, e zhvilloi aktivitetin e tij të mësimdhënies cilësore në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, përkatësisht në këto departamente: drejtësi, shkenca islame, shkenca komunikimi, gjuhë dhe letërsi angleze, shkenca kompjuterike dhe shkenca edukimi.

Kërkues shkencorë dhe studiues nga vendi, rajoni dhe mbarë bota kanë marrë pjesë në konferencat shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga Kolegji Universitar “Bedër”. Ata prezantuan punimet dhe kërkimet e tyre rreth temave bashkëkohore që janë problematike për rajonin dhe Shqipërinë, duke përbërë një bazë të mirë rekomandimesh për grupet e interesit.

REALIZIMI VJETOR I OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT

Realizimi i objektivave të mësimdhënies

Me anë të përdorimit të metodologjive të ndryshme të mësimdhënies dhe të vlerësimit, me anë të integritit të teknologjisë në mësimdhënie, prej zotërimit dhe vënies në dispozicion të mjediseve bashkëkohore të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore, programet e ofruara nga Kolegji Universitar “Bedër” synojnë dhe vlerësohet të kenë arritur nivelin e një arsimi cilësor që promovon mendimin analitik dhe gjykimin kritik në përgatitjen e studentëve për identifikimin, analizën, ndërtimin dhe vlerësimin e argumenteve.

Mësimdhënia cilësore dhe vlerësimi etik dhe profesional në KUB ka siguruar për të gjithë studentët mundësi të shkëlqyera për të përmbushur potencialin e tyre të plotë akademik, duke u mundësuar atyre të formohen në një mjedis arsimimi që u jep zemër dhe i mbështet, por dhe ku progresi akademik dhe rezultatet monitorohen e vlerësohen në mënyra alternative.

Përmes realizimit të një mësimdhënieje cilësore, bashkëkohore në përputhje me kurrikulat evropiane të arsimit të lartë është bërë i mundur sigurimi i një cilësie, që i pajis studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike, duke u dhënë siguri për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës. Kjo është arritur nëpërmjet realizimit të leksioneve të përbashkëta për studentët e interesuar nga të gjitha departamentet dhe disiplinat, ndërtimit të një bashkëpunimi efektiv ndërmjet njësive kryesore, me mbështetjen e dekanatit të studentëve, zyrës së planifikimit të karrierës, këshilltarëve akademikë dhe zyra të tjera në ndihmë të studentëve etj.

Përmes zgjerimit të mundësive për aktivitete të larmishme, si dhe me mundësitë për praktika ndërkombëtare, konkurset studentore dhe praktikat mësimore, përmes nxitjes së bashkëpunimit me universitete jashtë vendit dhe rritjes së kuotave të shkëmbimit të studentëve është arritur rritja e mundësive dhe përvojave ndërkombëtare.

Përmes organizimit të platformave të ndryshme të mësimdhënies online, u arrit përfundimi me sukses i procesit të vitit akademik 2020-2021.

Realizimi i objektivave të kërkimit shkencor dhe inovacionit

KUB ka synuar dhe synon përherë të sigurojë një komunitet kërkimor të suksesshëm dhe interaktiv që gjeneron ide, krijon fusha të reja të dijes dhe ndikon në ndryshimin e zhvillimit shoqëror, kulturor, mjedisor të Shqipërisë dhe komuniteteve globale. Hulumtimi përfshin personelin akademik, si dhe studentë të programeve të studimit në ciklin e parë “Bachelor” dhe ciklin e dytë “Master”.

Është arritur nxitja dhe mbështetja e pjesëmarrjes aktive të personelit akademik dhe studentëve në projekte dhe veprimtari kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo veprimtari është mundësuar nëpërmjet organizimit të ëorkshop-eve, konferencave shkencore, seminareve, simpoziumeve dhe trajnimeve të organizuara në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Janë ngritur dhe janë në funksionim mekanizma të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm për vlerësimin e performancës së aktiviteteve ndërdisiplinare (programet pasuniversitare, aktivitete kërkimore, etj.);

Është rritur niveli aktual i angazhimit dhe produktiviteti i personelit akademik, studentëve të diplomuar dhe atyre aktualë.

Janë marrë masa dhe zhvilluar aktivitete me bazë departamenti, fakulteti dhe institucioni për mbështetjen e inovacionit dhe ideve që ndikojnë në nxitjen e zhvillimit të shoqërisë dhe rritjen e ndikimit ndërkombëtar të institucionit.

Kjo dëshmohet në përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në shprehjen e ideve dhe mbështetjen e inovacionit si dhe në nxitjen dhe motivimin e tyre, që të fitojnë dhe të përdorin aftësitë e tyre sipërmarrëse dhe menaxhuese.

Është mbështetur shkëmbimi inovativ i përvojave të personelit akademik dhe studentëve me reparte dhe sektorë industrialë, institucione të ndryshme prodhuese apo me ofruesit e shërbimeve publike, por ndërkohë janë nxitur lidhjet me biznesin dhe komunitetin financiar për të mbështetur inovacionin dhe aktivitetet e institucionit.

Brenda mundësive që ofron Ligji i Arsimit të Lartë institucioni ynë arsimor ka prodhuar një sërë politikash që kanë ndihmuar në ecurinë sasiore dhe veçmas asaj cilësore. Në Statutin e KU

“Bedër”, Neni 4, Misioni dhe qëllimi i Kolegjit Universitar “Bedër”, është përcaktuar shprehimisht:

“Njohja me Deklaratën e Bolonjës (1999) dhe zbatimimi i Procesit të Bolonjës (2003) u hapi udhë përprjekjeve tona për t’u bërë pjesë e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë si dhe të kërkimit shkencor. Kontaktet institucionale të ndërthurura me ato personale të anëtarëve të personelit akademik me institucione dhe personel të IAL-ve të BE-së dhe SHBA-ve sollën njohjen më imtësisht, e cila ka ndihmuar për evidentimin më të mirë të përfitimeve prej zbatimit të parimeve që burojnë nga Deklarata e Bolonjës.”

Njëherazi me Konferencat Ndërkombëtare Shkencore në nivel departamenti dhe fakulteti, ku bashkë me pedagogët kanë mundur të jenë pjesëmarrës edhe studentët të ciklit të dytë të studimeve, kanë shkuar krah Konferencat Ndërkombëtare Shkencore të zhvilluara nga studentët, gjithnjë me ndihmën e njërive bazë, por dhe të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët, me zyrat e veta, së bashkë me Këshillin e Studentor

Si pasojë e projekteve të fituara dhe të realizuara me cilësi, disa pedagogë dhe mjaft studentët kanë realizuar projekte studimore apo vijuar studimet dhe kryer veprimtaritë shkencore në institucione të shquara brenda dhe jashtë shtetit.

Produktet e kërkimit shkencor janë të botuara në Proceeding me PDF, janë dokumentuar fizikisht në përmbledhje, ndërkohë që pritet të dalë nr. 12 i revistës “BJH” të Fakultetit të Shkencave Humane, që veç ISSN-së që botohet fizikisht, ka fituar edhe ISSN online, duke dhënë mundësi të lexohet në mënyrë digjitale gjithkund dhe kurdoherë. Ndërkohë vijon përgatitja për zhvillimin e 7-th ICHL, që do të mbahet më pas.

Zhvillimi i KU “Bedër” është mbështetur te:

- a. Zhvillimi i burimeve njerëzore duke u orientuar drejt kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik, me synimin për arritje cilësore në profesion.
- b. Lëvizshmëria e ekipeve: personeli akademik, ai administrativ i IAL-së së bashku me studentët.

Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave janë ngritur dhe funksionojnë mekanizma të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm për sigurimin e standardeve të aktiviteteve ndërdisiplinare (programet pasuniversitare, aktivitete shkencore-kërkimore, etj.)

Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit (KPGSCIPS)

KPGSCIPS ka në varësi Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KPSC). Në KPGSCIPS është bërë miratimi përfundimtar i planit të veprimit për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe të planit të veprimit për integrimin e personelit dhe të studentëve të huaj.

Gjithashtu, po në këtë komision, është miratuar plan-veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor, që ka përcaktuar objektivat, veprimtaritë, organin përgjegjës dhe afatin kohor të realizimit për vitin akademik gjegjës.

Për pasojë, është rritur niveli aktual i angazhimit dhe produktiviteti shkencor i personelit akademik, studentëve të diplomuar dhe atyre që vijojnë studimet. Duhet theksuar se janë marrë masa dhe zhvilluar aktivitete me bazë departamenti, fakulteti dhe si institucion për mbështetjen e inovacionit, ideve që ndikojnë në nxitjen e zhvillimit të shoqërisë dhe rritjen e ndikimit rajonal dhe ndërkombëtar të institucionit tonë.

KU “Bedër” ka mbështetur financiarisht jo vetëm procesin mësimor, por dhe prodhimtarinë shkencore, inovacionin e personelit akademik dhe të studentëve. Mbështetja financiare nga shteti shqiptar, që ndonëse modeste shpresojmë se do të vijojë të rritet, edhe për IAL-të joshtetërore, zhvillon më tej garën e tyre me IAL-të shtetërore duke sjellë cilësi – kërkim shkencor efikas – ndërkombëtarizim të tij.

3.1 INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCION APO MBI PROJEKTET QË MERR PJESE SI PALË AKTIVE

3.1.1 Politikat e kërkimit shkencor

Kolegji Universitar “Bedër” (KUB) është një institucion i arsimit të lartë i orientuar drejt kërkimit shkencor dhe si i tillë i kushton vëmendje të veçantë punës kërkimore. Roli i punës kërkimore është të mbështesë mësimdhënien, të pasurojë përvojën si për studentët ashtu dhe

personelin akademik dhe të kontribuojnë në ofrimin e studimeve, rekomandimeve dhe alternativave për zgjidhjen e problemeve bashkëkohore.

Bazuar në misionin e tij, Kolegji Universitar “Bedër”, i cili vlerëson dhe mbështet kërkimin shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, inkurajon të gjithë anëtarët e personelit akademik por dhe studentët për të qenë aktivë në fushën kërkimore, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen efektshmërinë akademike vjetore mbi tregues transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e personelit akademik vlerësohen nga një juri e posaçme, në bazë të kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren për nxitjen e publikimeve shkencore” të KUB, duke u pikëzuar sipas kriterëve përkatëse. Gjithashtu, çdo anëtar i personelit akademik përfiton një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kërkimore-shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

Ndër politikat e rëndësishme të Kolegji Universitar “Bedër” është nxitja e personelit akademik të institucionit që të publikojnë punët e tyre kërkimore në revista shkencore ndërkombëtare, në përfundim të të cilave ofrohet dhe një ndihmesë financiare. Në bazë të këtyre politikave mbështetëse, numri i artikujve shkencorë të botuar ka arritur në mbi 500 të tillë.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës kërkimore-shkencore të Kolegjit Universitar “Bedër” është dhe organizimi ose bashkorganizimi i konferencave dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore të një niveli ndërkombëtar. Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, janë organizuar disa seminare, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të fushave gjegjëse.

Pas çdo organizimi shkencor janë përgatitur përmbledhjet e kumtesave të konferencave, të cilat janë pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare dhe u janë dërguar pjesëmarrësve, por mund të gjenden online në faqen e internetit të KUB.

Gjithashtu, veç revistës së Fakultetit të Shkencave Humane (FSHH) “BJH”, vijon të publikohet në mënyrë periodike revista shkencore e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit (FFE) “Beder Journal of Educational Sciences” (BJES), edhe kjo me ISSN të dokumentuar fizikisht dhe online.

Me qëllim mbështetjen e personelit akademik, rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe inovacionit, në përputhje me hartimin e planit të ri strategjik 2018-2023, është rishikuar dhe harmonizuar strategjia e kërkimit shkencor. Gjithashtu janë rishikuar rregullorja dhe procedurat e zyrës së kërkimit shkencor dhe inovacionit në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e plotë dhe efektive e veprimtarisë kërkimore si dhe përputhshmëria me ligjin e ri të arsimit të lartë. Në këtë kuadër, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë të vitit 2015 dhe miratimin e statutit të ri të KUB, institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e progresit dhe raporteve përfundimtare të të gjitha granteve dhe projekteve të kërkimit.

Duke parë interesin dhe përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në përgatitjen e temave të diplomave, të tezave, në konkurset, projekte të organizuara si pjesë e programeve mësimore, si dhe pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore të organizuara nga KUB por edhe jashtë tij, është ngritur "Qendra për kërkuesit e rinj". Qendra ka për qëllim t'u ofrojë studentëve një mundësi unike për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor. E themeluar rishtazi, Qendra e Kërkuesve të Rinj shërben si një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për propozimin e iniciativave kërkimore-shkencore.

Në këtë kuadër, pas trajnimit të studentëve lidhur me metodat kërkimore dhe hartimin e projekteve, qendra ka organizuar konkursin e parë për propozimet në projekte kërkimore-shkencore, kurse projektet fituese do të financohen nga KUB ose do të paraqiten pranë institucioneve donatore.

Një tjetër aspekt i punës kërkimore të kryer në institucion është aplikimi dhe më pas pjesëmarrja, në përgjigje të thirrjeve për projekte nga organizata dhe institucione vendase apo ndërkombëtare, në fushën e kërkimit shkencor.

Në këtë drejtim, me qëllim mbështetjen e punës kërkimore dhe kërkimin aktiv të financimeve të jashtme nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në projekte kërkimore, në institucion vijojnë punën gjatë grupe kërkimore, përkatësisht: grupi kërkimor për të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane, grupi kërkimor për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve, grupi kërkimor për studime mediatike, grupi kërkimor i shkencave të edukimit, grupi kërkimor për studime fetare,

grupi kërkimor i mësimi të gjuhës angleze si gjuhë e dytë, të cilat janë riorganizuar sipas interesave në fushën e kërkimit, por dhe lëvizjeve të personelit.

Në këtë aspekt, Kolegji Universitar “Bedër” dhe konkretisht departamenti i shkencave të komunikimit, ka përfunduar me sukses projektin “Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonale përballë qasjes online të shërbimeve të tyre”. Projekti filloi dhe u krye në bashkëpunim dhe me financim të Autoritetit të Medieve Audiovizive, duke u realizuar nëpërmjet intervistave, organizimit të seminareve, konferencave shkencore dhe publikimit të gjetjeve, rezultateve dhe rekomandimeve të këtij kërkimi në një dokument shkencor përmbledhës.

Kolegji Universitar “Bedër” është pjesë si partner në projektin “Strengthening Civil Society to Build Youth Resilience to Violent Extremism” (Funded EuropeAid / 152207 / DD / ACT / AL) drejtuar nga Terre des Homme. Projekti synon të kontribuojë në sigurimin e pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve. Kolegji Universitar “Bedër” përfshihet në të të pjesa e studimit ku vlerësohen materialet e grumbulluara përmes një analize të situatës në tri komunitat e përfshira, duke sjellë një përfundim themelor për financuesit të granteve. Në të njëjtën kohë, studimet e ndërmarra gjatë realizimit të programit do të kenë ndikimin e tyre praktik në kundërshtimin e strategjive dhe praktikave të ekstremizmit të dhunshëm. Rezultatet e kërkimit do të shpërndahen tek institucionet kyçe të përfshira në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.

Plani strategjik i Kolegji Universitar “Bedër” parashikon tri elemente të rëndësishme për funksionimin e aktivitetit institucional: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe kontributin në shoqëri. Në këtë këndvështrim, rëndësi e veçantë i kushtohet pranimit të studentëve cilësorë, cilësisë së mësimi, cilësisë së kërkimit shkencor dhe mbështetjes së inovacionit.

Kërkimi shkencor ka qenë në themel të procesit akademik në Kolegjin Universitar “Bedër”, ku gjatë viteve akademike i gjithë personeli ka qenë i angazhuar në punë kërkimore. KUB ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në organizimet e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, Kolegji Universitar “Bedër” ka mbështetur pjesëmarrjen e studiuesve të rinj, veçanërisht të doktorantëve. Në kuadër të marrëdhënieve që ka ndërtuar me MASR, Kolegji Universitar “Bedër” zbaton politikat shkencore rajonale dhe

kombëtare duke i konkretizuar me aktivitete të realizuara dhe të tjera që planifikohen të mbahen në vijim. Ky institucion i arsimit të lartë ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj dhe për këtë arsye ka punësuar pedagogë të huaj nga disa shtete të ndryshme të botës, si: Turqia, Italia, SHBA, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. Kolegji Universitar “Bedër” me anë të udhëzimit për nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, angazhimin në projekte kërkimore, por edhe shpërblen arritjet akademike vjetore për indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Marrëveshjet që ka me universitetet partnere të projektit “Mevlana”, “Erasmus+” kanë mbështetur shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve.

Gjithashtu, institucioni punon ngushtë me agjencitë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë drejtim, Kolegji Universitar “Bedër” ka nënshkruar kartën për studiuesit evropianë, në përputhje me orientimin e AKTI. Personeli akademik është trajnuar nga AKTI në drejtim të zbatimit të projekteve dhe të programit “Horizont 2020”. Kolegji Universitar “Bedër” aplikon në mënyrë të vazhdueshme në projekte kërkimore në përgjigje të thirrjeve për aplikime në projekte hulumtuese-shkencore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Duke parë interesin dhe përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në konkurset e ndryshme gjatë realizimit të temave të diplomave në ciklin e parë të studimeve “Bachelor” apo të tezave të ciklit të dytë “Master”, gjatë projekteve të organizuara si pjesë e programeve mësimore, si dhe pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore të organizuara nga Kolegji Universitar “Bedër”, por edhe jashtë tij, me vendim të Senatit Akademik ka mbështetur "Qendrën për kërkuesit e rinj". Qendra ka për qëllim t’u ofrojë studentëve një mundësi unike për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor. KUB fton personel akademik të jashtëm të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura, si dhe në angazhime me kohë të pjesshme.

Në mbështetje të mbarëvajtjes së procesit akademik, Kolegji Universitar “Bedër” ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit bibliotekën e institucionit, e cila ofron një gamë të gjerë prej 36000 titujsh, të përzgjedhur sipas programeve të studimit të ofruara. Njëherazi mundëson shfrytëzimin e bibliotekës online **EbscoHost**, prej nga studentëve u afrohet përdorimi në mbi 45000 libra dhe mbi 5000 revista shkencore.

Me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së kërkimit shkencor, pranë Kolegji Universitar “Bedër” funksionon zyra e kërkimit shkencor, e cila harton dhe administron politikat që rregullojnë zhvillimin e kërkimeve në Kolegji Universitar “Bedër”, mbikëqyr zbatimin e programeve të tij të kërkimit, duke synuar të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë ndikimin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe komunitetit. Zyra e kërkimit shkencor shërben si organ koordinues ndërmjet institucioneve donatore dhe institucionit, mbështet institucionin dhe personelin akademik lidhur me informacionin mbi thirrjet e hapura për projekte dhe financime, si dhe aspektet teknike të procedurave të aplikimit

Ndër politikat e rëndësishme të Kolegjit Universitar “Bedër” është nxitja e personelit akademik të institucionit që të publikojnë punët e tyre kërkimore në revista shkencore ndërkombëtare, në përfundim të të cilave ofrohet dhe një ndihmesë financiare. Duke e mbështetur këtë aktivizim të ekipit akademik, kjo ka sjellë frytet e saj duke bërë që aktualisht personeli të ketë botuar mbi 400 artikuj shkencorë etj. Varësisht nevojave të programeve akademike, Kolegji Universitar “Bedër” ofron mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë qendra e medias dhe komunikimit, laboratorit i gjuhëve të huaja, laboratorit i kompjuterave, salla e gjyqit imitues etj.

Gjithashtu Kolegji Universitar “Bedër” merr pjesë në projektin e mëposhtëm:

“Scholas Occurrentes”, i cili është një iniciativë që synon të rinjtë në botë, fton të integrojnë në të studentët e universiteteve publike dhe private, të të gjitha besimeve fetare, për të edukuar të rinjtë në angazhimin për të mirën e përbashkët. “Scholas” është një organizatë ndërkombëtare e nxitur nga Papa Francisco që bashkëpunon me Kolegjin Universitar “Bedër” dhe komunitetet arsimore, publike dhe private, fetare dhe sekulare për të vendosur dhe mbajtur gjallë paktin arsimor. Si një organizatë e shoqërisë civile, kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve për të zbatuar kulturën e paqes përmes veprimtarive rinore.

4. SIGURIMI I CILESISE

4.1 PROJEKTI BOLOGNA HUB PEER SUPPORT

Përshkrimi i projektit

Projekti *Bologna Hub Peer Support* u koordinua nga Ministria Gjermane e Arsimit dhe Kërkimit dhe Agjencia Gjermane e Shkëmbimit Akademik (DAAD) në bashkëpunim me Erasmus+.

Nisur nga ideja për të krijuar "një qasje të strukturuar të mbështetjes së kolegëve bazuar në solidaritet, bashkëpunim dhe mësim të ndërsjellë", projekti synon krijimin e një grupi ekspertësh ndërkombëtarë të arsimit të lartë për të mbështetur institucionet në të gjithë EHEA për zbatimin e reformave të kartës së Bolonjës përmes metodave të të mësuarit nga kolegët/të tjerët. Ky projekt ka pasur si qëllim vetëm ofrimin e këshillimit në tematika të caktuara dhe nuk ka ofruar asnjë lloj granti për IAL-të pjesëmarrëse.

Bazuar në nevojat individuale të institucioneve të arsimit të lartë që pranohen të bëhen pjesë e projektit, ekspertët do të ofrojnë **këshillim gjatë vizitave/takimeve online ose në terren në tre pika kryesore:**

1. implementimi i strukturës së Kartës së Bolonjës në tre cikle Bachelor, Master, Doktoraturë
2. njohja e kualifikimeve në përputhje me Kartën e Bolonjës
3. sigurimi i cilësisë në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG,2015)

Çështje të tjera me detaje:

1. ECTS për mësimdhënien dhe të nxënit me në qendër studentin
2. formulimi i rezultateve të të nxënit
3. zhvillimi / modulizimi i kurrikulës
4. qasje inovative në mësimdhënie dhe në të nxënë (p.sh. dixhitalizimi)
5. lëvizshmëria (mobiliteti) dhe ndërkombëtarizimi
6. krijimi i kulturës së cilësisë ne institucion

Fazat e projektit

Misioni i këshillimit konsiston në një vizitë fillestare dhe një vizitë vijuese në institucionin (6-12 muaj pas vizitës së parë). Për shkak të pandemisë, i gjithë projekti u zhvillua online

Para vizitës së parë për këshillim, u kërkua plotësimi i një sondazhi online në lidhje me nevojat, sfidat dhe shkallën e zbatimit të projektit në institucion. Për këtë qëllim, u vendos një kontakt i drejtpërdrejtë midis institucionit dhe ekspertit të Bolonjës. (kjo është kryer gjatë aplikimit)

Gjatë vizitës/takimit së parë të këshillimit, ekspertët e Bolonjës dhanë këshilla praktike në mbështetje të zbatimit të praktikave të ndryshme brenda tematikës për të cilën është aplikuar. (18-19 Maj 2021)

Pas vizitës së parë, ekspertëve dhe institucionit u kërkohet të plotësojnë një sondazh në lidhje me vlerën e shtuar dhe mangësitë e mundshme të vizitës. Rezultatet do të ndihmojnë në përgatitjen dhe, nëse është e nevojshme, në organizimin e vizitës vijuese. (diku nëntor-dhjetor, mbetet për t'u diskutuar pas takimit të parë)

Midis vizitës së parë dhe të dytë institucioni do të përpiqet të zbatojë sugjerimet, idetë dhe rekomandimet e zhvilluara bashkërisht me ekspertin gjatë vizitës së parë këshilluese.

Pas periudhës së zbatimit, ekspertët kryejnë një vizitë në institucion në mënyrë që të diskutojnë dhe të pasqyrojnë së bashku sfidat specifike të paraqitura brenda fushës së periudhës së zbatimit. Nëse është e nevojshme, mendohet për mënyra të tjera për trajtimin e problemeve/sfidave.

Në fund të projektit, të gjithë IAL-të e përfshira janë të ftuara të marrin pjesë në një konferencë përfundimtare së bashku me ekspertët, konsorciumin e projektit dhe palët e tjera. Rezultatet do të diskutohen dhe publikohen në një punim përfundimtar.

Faza e aplikimit, pjesëmarrësit dhe takimet e organizuara

Kolegji Universitar “Bedër” aplikoi për t'u bërë pjesë e projektit gjatë periudhës dhjetor 2020 dhe pas pranimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me organizatorët, u përcaktuan ekspertët që i përshtateshin profilit të institucionit dhe tematikës së paraqitur në fazën e aplikimit^{1 2}.

Ekspertët:

1. **Prof. Philippe Bouillard** ka përvojë të gjerë në disa pozicione drejtuese si Shef Departamenti, zv/Dekan dhe zv/Rektor për Çështjet Akademike. Ai është marrë

¹ Formulari i aplikimit

² Dokumenti i pranimit në projekt

gjerësisht me sigurimin e cilësisë dhe me hartime programesh. Ai ka ekspertizë të gjerë dhe të thellë në një mori temash.

2. Prof. Sabine Schindler është Rektore e Universitetit UMIT TIROL dhe ka qenë zvRektore për Kërkimin Shkencor në Universitetin Innsbruck (Austri).

Përfaqësuesit e Bedër u përzgjedhën në vartësi të angazhimit të tyre në institucion me fushat e aplikuara³. Në takimet e organizuara sipas sesioneve, kanë marrë pjesë përfaqësuesit për çdo sesion dhe përfaqësuesi i KU “Bedër” për projektin si më poshtë :

1. **Përfaqësuesi i KU “Bedër”**: Dr.Enriketa Sogutlu
2. **Sesioni për ndërkombëtarizimin**: Dr.Ana Uka, MSc. Albana Çekrezi
3. **Sesioni për ECTS**: Prof.as Tidita Abdurrahmani, Dr.Erlis Çela, MSc. Ermira Shkreta
4. **Sesioni për Sigurimin e Cilësisë**: Dr.Nertil Bërdufi, Dr.Arti Omeri, MSc) Jola Marku

Pas vendosjes së kontaktit mes Kolegjit Universitar”Bedër” dhe ekspertëve u realizuan takimet si më poshtë:

A. Takimi përgatitor, 31.03.2021 mes ekspertëve dhe përfaqësuesit të KU “Bedër”, ku u bë një prezantimi i shkurtër të KU “Bedër”, si më poshtë:

- a. Prezantimi i KU “Bedër” nga koordinatoeja e projektit
- b. Pritshmëritë e KU “Bedër” nga projekti, pyetje dhe personat e angazhuar në projekt⁴
- c. Përcaktimi i datës së këshillimit me grupin e punës dhe ekspertët⁵
- d. Marrja e vendimeve përkatëse⁶ si më poshtë:
 - i. Data e takimeve të radhës: 18-19 maj 2021, takime nga 90 minuta për secilin sesion
 - ii. Përgatitja e materialeve dhe pyetjeve për secilin sesion të shprehur më lart
 - iii. Përfaqësuesit e Bedër për çdo sesion (dy/tre për grup së bashku me përfaqësuesin e IAL
 - iv. Platforma e takimeve online (ZOOM)

B. Takimet në institucion prill 2021 Në vijim të këtij takimit parapërgatitor, u përcaktuan pjesëmarrësit e KU “Bedër” për çdo sesion dhe me secilin grup u realizuan takime për

³ Vendimi për miratimin e grupit të punës

⁴ Pyetje dhe çështje të tjera për takimin e dytë

⁵ Axhenda e takimit të parë 31.03.2021

⁶ Relacioni i takimit të parë 31.03.2021

përcaktimin e nevojave dhe pyetjeve specifike për t'u diskutuar më pas me ekspertët. Pyetjet e përgatitura së bashku me materialet iu dërguan ekspertëve në përgatitje të takimeve pasuese.

C. Takimet me ekspertët 18-19 maj 2021 Këto takime u zhvilluan online në platformën ZOOM. në 5 seanca 90 minutëshe:

- | | | |
|----|-----------------------------------|------------|
| a. | 1 seancë prezantuese | 18.05.2021 |
| b. | 1 seancë për ndërkombëtarizimin | 18.05.2021 |
| c. | 1 seancë për ECTS | 19.05.2021 |
| d. | 2 seanca për sigurimin e cilësisë | 19.05.2021 |

Gjatë këtyre seancave interaktive u diskutuan problematikat e hasura në implementimin e udhëzimeve të kartës së Bolonjës dhe alternativat e mundshme për përmirësimin e praktikave ekzistuese ose përfshirjen e praktikave dhe procedurave të reja. Gjithashtu, u përcaktuan objektivat që KU “Bedër” duhet të realizojë gjatë fazës pasardhëse të projektit, si dhe periudha e vizitës së ekspertëve në institucion, në maj 2022.

Tematika dhe fokusi i çështjeve

Tre fushat për të cilat Kolegji Universitar “Bedër” aplikoi dhe u konsultua me ekspertët e Bolonjës bazuar si dhe pyetjet specifike për secilën prej tyre janë:

a. Ndërkombëtarizimi:

1. Si të promovohet dhe rritet mobiliteti i stafit dhe studentëve?
2. Cilat mënyra mund të aplikohen për të rritur bashkëpunimin strategjik, partneritetin dhe rritjen e kapaciteteve në aspektin e granteve, botimeve me bashkautorë të huaj dhe të projekteve?
3. Si mund të rritet vizibiliteti dhe networku?
4. Si mund të shtohen mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar nëpërmjet mësimdhënies online?

b. Udhëzime për ECTS

1. Si duhen llogaritur dhe shpërndarë ECTS-të për të siguruar një llogaritje sa më të mirë të punës dhe përkushtimit të studentit?

2. Cilat kritere duhen marrë parasysh në formulimin e rezultateve të të nxënit në një lëndë të caktuar me qëllim që të jetë në përputhje me objektivat e saj?
3. Si duhet organizuar kurrikula e një programi me qëllim që të përputhet me profilin dhe qëllimet e programit?
4. Cili është numri maksimal i lëndëve që mund të merren në një semestër në traditën më të mirë evropiane?
5. A mund të ndryshojë nr i ECTS-ve të një lënde në varësi të llojit të saj (e detyrueshme apo me zgjedhje)?
6. Si duhen llogaritur ECTS-të e lëndëve plotësuese që mund të merren në programet master? Si duhet ruajtur raporti i ECTS-ve midis praktikës profesionale dhe tezës?
7. Si mund të arrihet integrimi i metodave inovative në mësimdhënie dhe të nxënë? 8. Si mund të motivohen studentët për përdorimin e tyre⁷?

c. Sigurimi i cilësisë

- i. Si duhet të organizohet njësia e sigurimit të cilësisë për të funksionuar në mënyrë sa më efektive?
- ii. Si duhet zbatuar sigurimi i cilësisë duke ndjekur standardet evropiane (ESG)?
- iii. Si mund të krijohet kultura e cilësisë dhe përfshirja e të gjithë të interesuarve?
- iv. Si mund të vlerësohet se sa i ka arritur studenti rezultatet e të nxënit për lëndën? Çfarë instrumentesh mund të përdoren? Cilët aktorë mund/duhet të përfshihen?
- v. Si duhet të vlerësohet performanca e stafit dhe niveli i kënaqshmërisë së tij me institucionin?
- vi. Çfarë instrumentesh mund të përdoren? Kush duhet ta menaxhojë këtë vlerësim⁸?

Objektivat për secilën fushë

Gjatë takimeve u diskutuan arritjet, sfidat dhe problemet e hasura për secilën fushë. Më pas, u përcaktuan objektivat përkatëse të cilat Kolegji Universitar “Bedër” duhet të përpiqet t’i arrijë gjatë fazës së tretë të projektit.

1. Ndërkombëtarizimi:

⁷ Diskutimi për ECTS dhe objektivat përkatëse

⁸ Diskutimi për sigurimin e cilësisë dhe objektivat

- a. Rritja e networkut: pjesëmarrja e KU “Bedër” në takime ose ditë ndërkombëtare (EAIE ose ACA)
- b. Përgatitja e një skeme për mbështetjen e ndërkombëtarizimit

2. Udhëzimet për ECTS

- a. Ngarkesa e studentit: Do të rishikohet dhe vlerësohet nga komisioni vlerësues
- b. Zhvillimi dhe implementimi i vlerësimit periodik të programeve: duke filluar me hartimin apo përmirësimin e politikave dhe formalizimin e proceseve informale
- c. Profili i programit dhe rezultatet e të nxënit: a) rishikimi nga komisioni i brendshëm, b) organizimi i trainimit për përgatitjen e rezultateve të të nxënit dhe profilin e programit
- d. Platformë e mësimdhënies online: testimi i platformës Moodle ose të tjera.
- e. Motivimi: plan strategjik për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe të nxënit. Përfshirja e instrumenteve vlerësues (çmime) për stafin dhe studentët në politikën e institucionit.

3. Sigurimi i Cilësisë

- a. Rishikimi i politikave: identifikimi i mangësive dhe masat për veprime të mëtijshme
- b. Organizimi i një aktiviteti për SC me qëllim zgjerimin e kulturës së cilësisë (mund të koincidohet me vizitën e ekspertëve në institucion)
- c. Performanca e stafit: rishikimi i politikave dhe instrumenteve ekzistues për të siguruar përfshirjen e të gjithë kritereve (mësimdhënia, kërkimi shkencor, shërbimi ndaj komunitetit, përgjegjësitë administrative, etj)⁹

Projekti është promovuar edhe në faqen e institucionit¹⁰.

5. Përmbledhja e aktiviteteve që mund të organizohen në institucion:

1. Hartimi i politikave të sigurimit të cilësisë:

- a. Rishikimi i politikave dhe instrumenteve për vlerësimin e performancës së stafit
 - i. Rishikimi i politikave
 - ii. Përfshirja e politikave apo udhëzuesve të rinj
 - iii. Rishikimi i instrumenteve matës apo vlerësues aktualë

⁹ Relacioni i takimit të dytë



¹⁰ <https://www.beder.edu.al/en/news/top/beder-participates-in-the-bologna-hub-peer-support-project/1655>

- iv. Përfshirja e instrumenteve të reja të vlerësimit, kryesisht të drejtpërdrejta, për vlerësimin e mësimdhënies (për shembull, vëzhgime leksionesh dhe vlerësim në auditor)
 - b. Finalizimi i politikave për vlerësimin periodik të programeve (periodika, elementet, etj.)
 - i. Përgatitja dhe përfshirja e politikës së vlerësimit të brendshëm periodik të programeve në rregullore dhe udhëzuesit ekzistues
 - ii. Përgatitja e modelit të vlerësimit
 - iii. Përgatitja e modelit të raportimit
2. **Zbatimi pilotim Vlerësimi i një ose dy programeve:** Bachelor në 1) Shkenca komunikimi dhe 2) Shkenca kompjuterike (Ngritja e komisioneve të vlerësimit nga njësitë kryesore/bazë që ofrojnë programin në bashkëpunim me NJSBC për vitin akademik 2022-2023)
3. **Trajnime në lidhje me krijimin e kulturës së cilësisë dhe rritjen profesionale të stafit akademik emërtimet e trajnimeve mund të përditësohen/përshtaten)**
- a. Trajnim për vlerësimin e brendshëm periodik të programeve (shih pika 2 lart); pjesëmarrësit: komisionet e vlerësimit të programeve; pjesëmarrës: komisionet e vlerësimit për programet përkatëse, organizator: NJSBC, Shtator/Tetor 2022
 - b. Trajnim për përgatitjen e silabusit dhe formulimit të rezultateve të të nxënit; pjesëmarrësit: i gjithë stafi akademik; Shtator/Tetor 2022
 - c. Trajnime për përdorimin e platformave online Moodle (ose të tjera); pjesëmarrësit: stafi akademik; organizator: NJSBC dhe Burimet Njerëzore, Shtator/Tetor 2022
 - d. Metoda bashkëkohore të mësimdhënies; pjesëmarrës: stafi akademik, organizator: Burimet Njerëzore, Shtator/Tetor 2021
 - e. Trajnim në lidhje me etikën në arsimin e lartë për stafin akademik dhe administrativ
4. **Marrja në konsideratë e përfshirjes në kurrikula të një lënde në lidhje me etikën** si pjesë e rëndësishme në përmirësimin e shërbimeve që ofron universiteti, e rrjedhimisht, të cilësisë.

Konferenca përmbyllëse

Më datë 25 maj 2022 u zhvillua konferenca përmbyllëse e projektit. Në të morën pjesë ministrja e arsimit të Shqipërisë, znj.Evis Kushi, përfaqësues të DAAD, ekspertët pjesëmarrës në projekt dhe përfaqësues të IAL-ve pjesëmarrëse në projekt. Pas një prezantimi të qëllimit të projektit, u diskutuan vijueshmëria e projektit, arritja e pritshëmireve, si dhe ide për projekte të ardhshme.

Në përfundim, të gjitha IAL-ve pjesëmarrëse do t'u shpërndahen certifikata pjesëmarrjeje digjitale gjatë periudhës shtator-dhjetor 2022.



4.2 TRAJNIME

4.2.1 Workshop Online "Ethics in Higher Education: Plagiarism"

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizoi workshopin online “Ethics in Higher Education: Plagiarism” më datë 14.-2.2022 për stafin akademik dhe studentët e programeve master. Workshopi u prezantua nga Dr.Vera Ndrecaj, profesore në Universitetin i Kardifit, në Mbretërinë e Bashkuar. Workshopi trajtoi rëndësinë e origjinalitetit në punime shkencore dhe kontributin që ai sjell në zhvillimin e shoqërisë. Pas workshopit, të gjithë pjesëmarrësit patën mundësin të bënin një udhëtim virtual në universitetin e Kardifit, gjatë të cilit u njohën kryesisht me bibliotekën e universitetit dhe mundësitë që ai ofron për studentët.

Dr. Vera Ndrecaj është Lektore e Lartë dhe Menaxhere Projekti (programi MBA) në Shkollën e Menaxhimit të Cardiff-it. Ajo është gjithashtu një Këshilltare Akadematike në operimin/projektin e Praktikës së Komuniteteve të Ekonomisë Cirkulare të CCR.

Ajo është pedagoge, studiuese dhe konsulente me përvojë universitare me një histori të provuar të punës në industrinë e arsimit të lartë. Para se t'i bashkohej CSM-së, Dr. Ndrecaj ka qenë Lektore në Menaxhimin e Zinxhirit të Furnizimit në Universitetin e Uellsit të Jugut, ku ajo ka drejtuar me sukses programet universitare dhe pasuniversitare. Dr. Ndrecaj fitoi Ph.D. në Universitetin e Uellsit Jugor, MB.

Në trajnim morën pjesë 20 studentë të programeve master dhe 20 pedagogë të kolegjit universitar “Bedër”. Pjesëmarrësit u pajisën me certifikata.



4.2.2 Online Workshop: “Innovative Approaches to Teaching: Entrepreneurship Education”

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomisë dhe Biznesit organizoi workshopin online “Innovative Approaches to Teaching: Entrepreneurship Education” më datë 10.03.2022. Workshopi u prezantua nga Ass.Prof. Dr.Valentina Ndou, profesore në Universitetin i Salentos, në Itali.

Valentina Ndou është Professore e Shkencës dhe Inxhinierisë së Menaxhimit në Departamentin e Inxhinierisë për Inovacion - Universiteti i Salentos (Lecce, Itali). Ajo ka më shumë se 20 vjet përvojë me projekte kërkimore evropiane, ndërkombëtare dhe kombëtare. Gjithashtu ka përvojë të gjerë në mësimdhënie dhe edukim në lëndët që lidhen me biznesin elektronik, transformimin digjital, edukimin për sipërmarrjen, menaxhimin e projekteve, menaxhimin inovativ të sistemeve

të turizmit, dhe vendet në zhvillim. Ajo ka qenë menaxhere e projektit dhe përgjegjëse në projekte të ndryshme ndërkombëtare si Interreg Italia-Albanna-Mali i Zi (2018-2021). Ajo shërben si eksperte për vlerësimin e projekteve për fonde të ndryshme shkencore dhe kërkimore (p.sh. këshilli i shkencës së Lituaniës, fondi shkencor i Serbisë). Ajo është emëruar eksperte këshilluese e Këshillit Akademik Ndërkombëtar të Institutit të Forumit Botëror të Turizmit dhe është anëtare e komitetit shkencor të Laboratorit të Kontaminimit të Universitetit të Salentos, laboratorit ekstrakurrikular që synon përhapjen e kulturës së sipërmarrjes tek studentët e rinj. Në trajnim morën pjesë 15 anëtarë të stafit akademik.



4.3 AKREDITIME

1. Vlerësim i brendshëm dhe i jashtëm

Gjatë vitit akademik 2022-2023, NJSBC u angazhua në procesin e akreditimit të tre programeve: dy në ciklin e parë, Bachelor në Shkenca Kompjuterike, dhe program profesional dy-vjeçar në Multimedia dhe Dizajn Grafik, dhe një në ciklin e dytë, Master i shkencave ë Drejtësi.

Pas njoftimit të departamenteve që ofrojnë programet, u ngritën grupet e punës dhe NJSBC organizoi takime informuese dhe koordinuese për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjatë gjithë procesit, NJSBC ka asistuar në çdo rast me sqarime për t'ia lehtësuar punën grupeve të punës deri në finalizimin e procesit me dërgimin e dosjeve të vetëvlerësimit në ASCAL brenda muajit shkurt 2022.

Me fillimin e vlerësimit të jashtëm në muajin prill 2022, u organizuan pritjet e grupeve të vlerësimit të jashtëm në institucion, përgatitja e departamenteve, GVB-ve dhe studentëve të programeve përkatëse për takimet me GVJ. NJSBC koordinoi punën për dërgimin e raporteve të vlerësimit të jashtëm si dhe përcjelljen e tyre në departamente. Ajo mori masat që dërgimi i komenteve për draft raportet dhe raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm të bëheshin brenda afateve të përcaktuara në manualin e ASCAL-it për akreditimin e programeve si më poshtë:

1. Program profesional dy-vjeçar në Multimedia dhe Dizajn Grafik, 11/10/2022

2. Programi Master i shkencave ë Drejtësi, 11/10/2022

3. Programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike është ende në pritje të draft-raportit

Ndërkohë pas mbërritjes së vendimit të bordit të akreditimit për vlerësimin e jashtëm të institucionit dhe të tre programeve të akredituara gjatë vitit akademik 2020-2021, NJSBC u kujdes për organizimin e brendshëm për përgatitjen e plan-veprimit për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga BA për institucionin dhe secilin program. Me ngritjen e grupeve të punës për secilin program dhe atë institucional, NJSBC ofroi konsulencë në rastet kur u pa e nevojshme. Dërgimi i planveprimeve në ASCAL është bërë sipas datave të mëposhtme:

1. Planveprimi për përmbushjen e rekomandimeve për institucionin 13.06.2022

2. Planveprimi për përmbushjen e rekomandimeve programi bachelor në marrëdhënie publike dhe komunikim arketingu 21/10/2022

3. Planveprimi për përmbushjen e rekomandimeve programi master profesional në komunikim marketingu 21/10/2022

4. Planveprimi për përmbushjen e rekomandimeve programi Bachelor në Teknologji informacioni dhe TIK. 21/10/2022.

2. Aplikim për akreditim programesh

Gjatë muajit maj u krye aplikimi për akreditimin e pesë programeve, tre prej të cilave të reja dhe dy të riorganizuara si më poshtë vijon:

1. Diplomë profesionale në Programim web

2. Master i shkencave në shkenca kompjuterike

3. Master i shkencave në shkenca islame

4. Master i shkencave në studime religjioze

5. Master profesional në mësuesi gjuhë angleze.

4.4 ANKETA

Gjatë vitit akademik 2021-2022, NJSBC ka zhvilluar ose ka dhënë orientimet për organizimin e pesë anketime, tre për studentët, një për stafin akademik dhe një për stafin administrativ, si dhe formularin e vetëvlerësimit për stafin akademik, si më poshtë:

1. Anketë e studentit për vlerësimin e pedagogut dhe lëndës për semestrin e parë shkurt 2022
2. Anketë vlerësimi e studentit për pedagogun dhe lëndën për semestrin e dytë Korrik 2022
3. Anketë vlerësimi e studentit për institucion dhe shërbimet që ai ofron Korrik 2022
4. Anketë vlerësimi e stafit akademik për institucionin
5. Anketë vlerësimi e stafit administrativ për institucionin
6. Formular vetëvlerësimi i stafit akademik

1. Anketat e studentit për vlerësimin e pedagogut dhe lëndës

zhvillohen çdo fund semestri gjatë periudhës së provimeve finale. Çdo student vlerëson pedagogun dhe lëndën përkatëse për atë semestër. Vlerësimi i mëtejshëm dhe diskutimi i rezultateve bëhen në rang departamenti dhe hierarkie.

2. Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik

zhvillohet në muajin e fundit të viti akademik dhe çdo anëtar i stafit plotëson fusha të ndryshme në lidhje me veprimtarinë akademike, kërkimore, etj përgjatë vitit. Më pas ai diskutohet midis përgjegjësit të departamentit dhe secilit anëtar të stafit dhe përcillet më tej në dekanatin e fakultetit për në senat.

Për dy anketat e lartpërmendura, NJSBC luan vetëm rol konfirmues në lidhje me aplikimin e këtyre anketave.

3. Anketë vlerësimi e studentit për institucionin dhe shërbimet që ai ofron

Gjatë vitit akademik 2019-2020 dhe 2020-2021 kjo anketë nuk është zhvilluar për studenttë pasi leksionet janë organizuar online. Për vitin akademik 2021-2022, numri i pjesëmarrësve në anketë është 107 studentë me pjesëmarrje nga departamentet si më poshtë:

Shkenca komunikimi 45%

Shkenca kompjuterike	21%
Edukim dhe gjuhë angleze	12%
Drejtësi	9%
Shkenca islame	7.5%
Ekonomi dhe biznes	5.5%

Për sa u përket cikleve, 52% e pjesëmarrësve janë studentë të programeve master dhe 48% të programeve të ciklit të parë. Në rang departamenti, 45% e pjesëmarrësve janë nga departamenti i shkencave të komunikimit, 21% nga shkencat kompjuterike, 12% nga departamenti i edukimit dhe gjuhës angleze, 9% nga departamenti i drejtësisë, dhe 7.5% departamenti i ekonomisë dhe biznesit dhe 6.5% departamenti i shkencave islame.

Vlerësimi më poshtë është bërë në bazë të 3 (tre) seksioneve me pohime të organizuara sipas shkallës Likert, dhe një (1) seksioni me sugjerime.

Infrastruktura dhe Shërbimet

Pyetja 1 Në lidhje me faqen e Webit të institucionit 82.3% e studentëve janë shprehur se janë dakord ose plotësisht dakord që faqja ofron një informacion të mjaftueshëm në lidhje me orarin mësimor, aktivitetet e ndryshme, regjistrimet etj. 12.1% e tyre janë pjesërisht dakord dhe pjesa tjetër (6%) nuk janë dakord me këtë pohim.

Pyetja 2 Për sa u përket shërbimeve teknologjike të tilla si interneti, tabelat interaktive, kompjuterat, etj., 77.5% e studentëve janë të kënaqur me këto shërbime, 12.1% e tyre ndajnë një mendim neutral dhe 10.4% e studentëve nuk janë të kënaqur me këto shërbime.

Pyetja 3 Mbi 90% e studentëve mendojnë se procesi i regjistrimit të lëndëve në BIS është i lehtë, 5% ndajnë mendim neutral dhe 5% nuk janë dakord me këtë pohim.

Pyetja 4 51.4% e studentëve janë plotësisht dakord që në Sistemin BIS gjejnë informacione në lidhje me programin e studimit, 34.6% janë dakord, 9.3% janë pjesërisht dakord dhe pjesa tjetër (5%) nuk janë dakord .

Pyetja 5 Për marrjen e dokumenteve të nevojshme (vërtetim studentit, transkript, etj) në një kohë të shkurtër 73.9% e studentëve janë shprehur se bien shumë dakord ose dakord, 18.7 % e tyre janë pjesërisht dakord dhe afërsisht 7% e tyre nuk janë dakord.

Pyetja 6 83.2% e studentëve janë shumë të kënaqur me komunikimin që kanë me njësitë administrative (departamentin, fakultetin, etj.), 14% e tyre kanë një mendim të mesëm dhe pjesa e mbetur (3%) nuk janë të kënaqur.

Pyetja 7 Për sa i përket shërbimit të bibliotekës 78.5% e studentëve janë të kënaqur nga ky shërbim, 16.8% e tyre janë pjesërisht të kënaqur dhe 4.7% e tyre nuk janë të kënaqur.

Pyetja 8 64.5% e studentëve bien dakord që janë të kënaqur me bibliotekën online JSTOR, 30.8% e tyre janë pjesërisht të kënaqur, pjesa tjetër nuk janë të kënaqur.

Pyetja 9 Për 36.4% të studentëve literatura e bibliotekës është plotësisht e mjaftueshme, për 29% të tyre kjo literaturë është disi e mjaftueshme, 29% e tyre kanë mendim neutral dhe pjesa e vogël e mbetur mendojnë se kjo literaturë nuk është e mjaftueshme.

Pyetja 10 Për pohimin se ambientet e mësimin janë të bollshme dhe motivuese, 76.6% e studentëve bien dakord dhe shumë dakord, 15% e tyre janë pjesërisht dakord dhe 8.4% e tyre nuk janë dakord. Asnjë nga studentët nuk është aspak dakord me këtë pohim.

Pyetja 11 Në lidhje me kushtet higjieno-sanitare, 90.6 % e studentëve janë të kënaqur, 8.4% e tyre janë pjesërisht të kënaqur dhe vetëm 1% e tyre nuk janë të kënaqur.

Pyetja 12 Në lidhje me nivelin e kënaqshmërisë që kanë studentët me ambientet sociale të institucionit 79.4% e tyre shprehen se janë shumë të kënaqur, 18.7% e tyre janë pjesërisht të kënaqur dhe vetëm 2% e tyre nuk janë të kënaqur.

Si përfundim,

Për sa i përket website-it dhe teknologjive që ofron institucioni mund të themi se shumica e studentëve ndajnë një mendim pozitiv, një pjesë e vogël e tyre kanë një qëndrim të mesëm (15%-16%) dhe një pjesë shumë e vogël e tyre kanë mendim negativ.

Mbi 85% e studentëve mendojnë se BIS është shumë i lehtë për tu përdorur, pjesa tjetër ka një mendim neutral dhe një pjesë shumë e vogël ka vështirësi me sistemin.

Në lidhje me komunikimin me zyrat administrative shumica e studentëve janë të kënaqur, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë pjesërisht të kënaqur. Edhe në lidhje me bibliotekën një pjesë e konsiderueshme janë pjesërisht të kënaqur, shumica janë të kënaqur. Pothuajse të gjithë

studentët janë shumë të kënaqur me ambientet e institucionit, një pjesë e vogël janë pjesërisht të kënaqur.

Në përgjithësi studentët janë të kënaqur me të gjitha shërbimet në masën mbi 73% . Ndërkohë që shërbimi më i vlerësuar në lidhje me infrastrukturën janë kushtet higjieno-sanitare dhe lehtësia e regjistrimit të lëndëve në BIS, shërbimi me vlerësim më të ulët është ofrimi i dokumentacionit në kohë të shkurtër (73%).

Për sa i përket vetë infrastrukturës, mjaftueshmëria e literaturës në bibliotekë është pika ku 40% e studentëve shprehen se e gjejnë disi ose jo gjithmonë. Në lidhje me teknologjinë në mjediset e universitetit 23% shprehen se nuk janë të kënaqur,

B.Mbështetja dhe këshillimi akademik

Pyetja 13 82% e studentëve pjesëmarrës janë të kënaqur me këshillimin akademik, 13 kanë mendim neutral dhe 5% nuk mendojnë se këshillimi akademik është në nivele të kënaqshme.

Pyetja 14-15 Në lidhje me organizimin e semestrit të verës, vetëm rreth 4% shprehen se nuk janë të kënaqur me këtë mundësi, 31% janë neutralë dhe 65% janë të kënaqur me këtë mundësi. Për sa i përket organizimit të riprovimeve apo provimeve shtesë, 77% e vlerësojnë pozitive këtë mundësi, 19% janë neutralë dhe 5% nuk janë dakord me këtë mundësi.

Pyetja 16 86% e studentëve mendojnë se organizimi i aktiviteteve akademike në institucion është i mjaftueshëm, 10% janë neutralë dhe 4% mendojnë se numri i aktiviteteve akademike nuk është i mjaftueshëm.

Mbështetja dhe këshillimi akademik kanë marrë një vlerësim të përgjithshëm pozitiv në masën mbi 77%. Nuk ka ndonjë aspekt të vlerësuar negativisht ose shumë negativisht.

C.Mbështetja nga dekanati i studentit

Në lidhje me mbështetjen që u ofrohet studentëve nga dekanati i studentit dhe zyrat përkatëse, është bërë nga një pyetje për secilën zyrë.

Pyetja 17-18 67% e studentëve janë të kënaqur me aktivitetet e klubeve studentore, 25% kanë mendim neutral dhe 7% janë të pakënaqur me organizimet e kësaj zyre. E njëjta panoramë paraqitet edhe në lidhje me aktivitetet social-kulturore, ku 67% shprehen se ato janë të mjaftueshme, 25% shprehin mendim neutral dhe 5% shprehen se nuk janë të mjaftueshme.

Pyetja 19 Në lidhje me shërbimet e zyrës psiko-sociale 68% shprehen të kënaqur, 26% janë neutralë dhe 6% shprehen se janë të pakënaqur. Edhe në lidhje me zyrë e karrierës vihet re një tablo e përafërt, ku 68% shprehen të kënaqur, 26% neutralë dhe 6% të pakënaqur.

Në lidhje me të gjitha shërbimet e ofruara nga dekanati i studentit, studentët pjesëmarrës shprehen të kënaqur në masën 66%, pra 2/3 e studentëve janë të kënaqur me këto shërbime dhe pjesa tjetër janë ose neutralë (rreth 25%) ose të pakënaqur (4-5%).

4. Anketë vlerësimi e stafit akademik për institucionin

Për vitin akademik 2021-2022, numri i pjesëmarrësve në anketë është 37 anëtarë të stafit akademik. Vlerësimi më poshtë është bërë në bazë të katër (4) të seksioneve me pohime të organizuara sipas shkallës Likert, dhe një (1) seksioni me sugjerime.

Shërbimet e ofruara në institucion

Pyetja 1 Në lidhje me kushtet e hapësirave që ofron institucioni, 72% e pjesëmarrësve shprehen se janë të kënaqur me ambientin, 21.5% janë pjesërisht të kënaqur dhe 5% janë të pakënaqur ose aspak të kënaqur me mjediset që ofron institucioni.

Pyetja 2 Për 94% të anëtarëve të stafit akademik, kushtet higjieno-sanitare janë të kënaqshme ose plotësisht të kënaqshme, dhe vetëm 6% e pjesëmarrësve janë pjesërisht dakord se kushtet janë të kënaqshme. Asnjë pjesëmarrës nuk shpreh totale me kushtet higjieno-sanitare.

Pyetja 3 Për sa i përket sigurisë në institucion, 86% e stafit janë dakord ose plotësisht dakord se kushtet e sigurisë në institucion janë të kënaqshme, 11% janë pjesërisht dakord dhe 5% nuk janë dakord ose aspak dakord.

Pyetja 11 85% e pjesëmarrësve janë të kënaqur me ushqimin e ofruar, 11 janë pjesërisht të kënaqur dhe 5% nuk janë edhe aq të kënaqur me këtë shërbim.

Pyetja 4 Në lidhje me shërbimet teknologjike që ofrohen në institucion, ndërkohë që 58% mendojnë se janë në nivele të kënaqshme, 19% dhe 5% respektivisht nuk janë dakord ose nuk janë aspak dakord me këtë mendim. Gjithashtu, 19% e pjesëmarrësve janë pjesërisht dakord se shërbimet teknologjike janë në nivele të kënaqshme,

Pyetja 5 Për sa i përket sistemit informativ BIS, ai është në nivele plotësisht të kënaqshme ose të kënaqshme përkatësisht për 30% dhe 40%, në mënyrë të pjesshme për 27%, dhe jo të kënaqshme për 3% .

Pyetjet 6-7 81% e stafit mendojnë se janë të informuar në lidhje me zhvillimet në institucion dhe 18% mendojnë se informimi është i pjesshëm. Për sa i takon kohës së informimit, 70 % mendojnë se informimi bëhet në kohë, dhe 27% janë të mendimit se informimi bëhet pjesërisht në kohën e duhur, dhe 3% shprehen se informimi nuk bëhet gjithmonë në kohën e duhur.

Pyetjet 8-10 Për sa i përket shërbimit të bibliotekës, 73% janë të kënaqur, 19% janë pjesërisht të kënaqur dhe 8% nuk janë të kënaqur. Ndërkohë, në lidhje me literaturën, vetëm 35% e anëtarëve të stafit akademik mendojnë se mund ta gjejnë në bibliotekë literaturën e nevojshme, pjesa tjetër mendojnë se e gjejnë pjesërisht (38%), rrallë (8%) ose asnjëherë (8%) literaturën që u duhet.

Si përfundim, pjesa më e madhe e stafit është në përgjithësi e kënaqur me shërbimet e ofruara, kryesisht me kushtet higjeno-sanitare dhe ushqimin.

Për sa u përket shërbimit të bibliotekës dhe gjendjes së literaturës së nevojshme, vihet re se pak më shumë se një e treta e stafit e gjen literaturën e nevojshme në bibliotekë dhe pjesa dërrmuese luhetet midis e gjen pjesërisht, rrallë ose fare. Kjo pikë duhet marrë në konsideratë për përmirësim duke punuar për shtimin e zërave përkatës për çdo program studimi në bibliotekë.

Në lidhje me shërbimet e teknologjisë, pak më shumë se 50% e stafit shprehet e kënaqur me këtë shërbim, ndërkohë që pjesa tjetër shpreh pakënaqësi të pjesshme në nivele të ndryshme. Edhe sistemi i informimit BIS është një pikë për të cilën stafi shprehet se lë për të dëshiruar. Kjo mbështetet edhe me pikën e fundit të anketës ku disa anëtarë shprehen për nevojë të domosdoshme të përditësimit të teknologjisë në institucion si dhe të sistemit informativ BIS duke e lidhur atë me shërbime të tjera me qëllim lehtësimin e proceseve të ndryshme të informimit dhe publikimit.

Nuk ka asnjë shërbim ndaj të cilit të ketë pakënaqësi totale. Shërbimi që mund të merret në konsideratë për përmirësim është ofrimi i literaturës së nevojshme, bazuar në analizë të nevojave sipas departamenteve si dhe rinovimi i teknologjisë nëpër auditore.

Bashkëpunimi në departament dhe në institucion

Bashkëpunimi në departament u mat me anë të katër pyetjeve dhe ai në institucion me anë të tre pyetjeve.

Pyetja 13 Në lidhje me bashkëpunimin me koordinatore të departamentit, 46% e pjesëmarrësve shprehen të kënaqur dhe 40% plotësisht të kënaqur. Ndërkohë që 11% janë pjesërisht të kënaqur me këtë bashkëpunim, 3% shprehin pakënaqësi në lidhje me bashkëpunimin me koordinimin e departamentit.

Pyetja 14 Fryma e bashkëpunimit në departament rezulton me 32% plotësisht të kënaqur, 49% kënaqur dhe 19% disi të kënaqur. Edhe pse asnjë pjesëmarrës nuk shprehet për pakënaqësi totale, vihet re një rënie me 6% e nivelit të frymës së bashkëpunimit në departamente në krahasim me vitin e kaluar.

Pyetja 15-16 Për sa i përket vendim-marrjes në departament, 81% mendojnë se departamenti mbledhet rregullisht për vendim-marrje, ndërsa pjesa tjetër shprehen se pjesërisht dakord (16%) ose jo dakord (3%) me mbledhjen e rregullt të departamentit për vendim-marrje. Në lidhje me përfshirjen në vendim-marrje, ndërkohë që 54% dhe 27% mendojnë se janë plotësisht të përfshirë ose të përfshirë në këtë proces, 10% mendojnë se janë pjesërisht të përfshirë, dhe 8% mendojnë se janë jo të përfshirë ose aspak të përfshirë në vendim-marrje në nivel departamenti.

Pyetja 12 Edhe në lidhje me bashkëpunimin në institucion rezulton se pjesëmarrësit janë të plotësisht të kënaqur (30%) ose të kënaqur (51%), dhe vetëm 19% janë pjesërisht dakord se ka bashkëpunim mes stafit akademik dhe atij administrativ në institucion. Këtu vihet re një rënie në masën 13% të nivelit të bashkëpunimit midis stafit, sipas pjesëmarrësve në sondazh.

Si përfundim, mund të thuhet se në institucion promovohet fryma e bashkëpunimit. Për të rritur përfshirjen e stafit në vendim-marrje, mund t'i mësohet më shumë rëndësisë së saj në nivele drejtimi, fakultet apo departament. Mund të merret në konsideratë analizimi i mëtejshëm i arsyeve që çojnë në mendimin se bashkëpunimi midis stafit akademik dhe administrativ nuk është në nivele aq të kënaqshme.

Politikat dhe menaxhimi i institucionit

Pyetja 17-18 Për sa i përket menaxhimit dhe drejtimit të institucionit, 65% mendojnë se ai bëhet në mënyrë të denjë, 24% janë pjesërisht dakord me këtë, ndërsa 11% mendojnë se institucioni nuk drejtohet dhe menaxhohet mirë. Ndërkohë që 65% mendojnë se drejtuesit e institucionit kanë një vizion të qartë për zhvillimin strategjik të institucionit, pjesa tjetër janë pjesërisht dakord (22%), jo dakord (5%) dhe aspak dakord (8%).

Pyetja 19 Për sa i përket përcjelljes së ankesave në organet drejtuese, 85% mendojnë se mund ta bëjnë lirisht, 16% janë disi dakord, dhe 8% nuk janë dakord se përcjellja e ankesave është lehtësisht e realizueshme.

Pyetja 20 62% e pjesëmarrësve mendojnë se janë të përfshirë në vendim-marrje në institucion, 24% janë pjesërisht dakord dhe 14% mendojnë se nuk janë të përfshirë në vendim-marrje.

Pyetja 21 Pyetjes në lidhje me mbështetjen e ideve inovative, 62% e stafit shprehen se janë të kënaqur, 30% disi të kënaqur, dhe 8% mendojnë se mendimet inovative nuk mbështeten sa duhet.

Pyetja 22-23 Ndërkohë që 95% e stafit mendon se studentët përbëjnë përparësi për institucionin, vetëm 5% shprehen se sipas tyre studentët nuk janë përparësi për institucionin. dhe marrëdhëniet mes stafit dhe studentëve janë të kënaqshme. Edhe për sa u përket marrëdhënieve mes stafit dhe studentëve, 97% e pjesëmarrësve shprehen se ato janë në nivele të mira, dhe vetëm 3% janë pjesërisht dakord me këtë.

Pyetja 24 Pjesa dërrmuese e stafit (86%) mendon se në institucion nxitet fryma e bashkëpunimit dhe e komunikimit të mirë mes kolegëve, 8% janë pjesërisht dakord dhe 5% mendojnë se në institucion nuk nxitet fryma e bashkëpunimit dhe komunikimit.

Pyetja 25 Pak më shumë se gjysma e stafit pjesëmarrës (59%) mendon se institucioni ofron mundësitë mjaftueshme për zhvillimin profesional, 22% janë pjesërisht dakord dhe 19% nuk mendojnë se në institucion ofrohen mundësi të mjaftueshme për nevojat zhvillimit profesional.

Pyetja 26 ndërkohë që 73% e pjesëmarrësve shprehen se u janë bërë të qarta përgjegjësitë dhe detyrat në lidhje me pozicionin që kanë, 19% janë pjesërisht dakord, dhe pjesa tjetër (8%) shprehen se nuk u janë bërë të qarta detyrat dhe përgjegjësitë.

Ndërkombëtarizimi

Pyetje 27-29 Për sa i përket ndërkombëtarizimit, 73% mendojnë se institucioni i kushton rëndësi prezantimit ndërkombëtar, 16% janë pjesërisht dakord dhe 11% mendojnë se nuk i kushtohet rëndësia e nevojshme. Në lidhje me promovimin e kërkimit shkencor, më pak se gjysma e pjesëmarrësve (40%) mendojnë se institucioni bën mjaftueshëm për nxitjen e kërkimit shkencor, pothuaj po aq (43%) janë pjesërisht dakord se në këtë drejtim bëhet mjaftueshëm dhe pjesa tjetër (17%) mendojnë se nuk bëhet mjaftueshëm në këtë drejtim. Si pjesë e rëndësishme e ndërkombëtarizimit, mobiliteti i stafit është një pikë për të cilën 59% mendojnë se promovohet mjaftueshëm, 30 % janë pjesërisht dakord se bëhet mjaftueshëm dhe pjesa tjetër 11% nuk janë dakord që institucioni i kushton rëndësinë e duhur apo i promovon mjaftueshëm programet e shkëmbimit.

Si përfundim, me përjashtim të një pjese të vogël, pjesëmarrësit mendojnë se në përgjithësi menaxhimi dhe drejtimi i institucionit është në nivele të kënaqshme. Pothuaj një e treta e pjesëmarrësve mendojnë se duhet më shumë pjesëmarrje në vendim-marrje dhe promovim apo nxitje e ideve inovative.

Për sa i përket ndërkombëtarizimit, edhe pse shumica e pjesëmarrësve janë dakord që institucioni i kushton rëndësi ndërkombëtarizimit, vihet re se në hapa konkretë stafi ka më shumë pritshmëri për përfshirje në programe shkëmbimi, dhe për nxitjen dhe promovimin e kërkimit shkencor.

Ngarkesa dhe vlerësimi i punës

Pyetja 30 Pyetja në lidhje me ngarkesën nxjerr në pah se 65% mendojnë se ngarkesa e tyre është e pranueshme, 19% mendojnë se ajo është pjesërisht e përballueshme dhe 16% mendojnë se ngarkesa e tyre në punë nuk është e pranueshme.

Pyetja 31 Në lidhje me vlerësimin për punën që bëjnë, 64% ndihen të vlerësuar, 27% disi të vlerësuar dhe 8% nuk ndihen të vlerësuar për punën që bëjnë.

Pyetja 32 Në total, 84% e pjesëmarrësve janë të kënaqur që punojnë në KU Bedër, dhe vetëm 16% janë disi të kënaqur për këtë, ndërkohë që asnjë pjesëmarrës nuk shprehet i pakënaqur apo totalisht i pakënaqur që punon ë kolegjin universitar “Bedër”.

Si përfundim, mund të thuhet se 2/3 e stafit mendojnë se kanë ngarkesë të përballueshme dhe rreth 1/3 e stafit akademik pjesëmarrës në anketë mendon se kanë mbingarkesë në punë. Për sa i përket vlerësimit në punë dhe kënaqësinë e të qenit pjesë e institucionit, 2/3 ndihen të vlerësuar dhe 84% janë të kënaqur që punojnë në Bedër.

5. Anketë vlerësimi e stafit administrativ për institucionin

Anketës i janë përgjigjur vetëm 11 anëtarë të stafit administrativ. Vlerësimi më poshtë është bërë në bazë të katër (4) të seksioneve me pohime të organizuara sipas shkallës Likert, dhe një (1) seksioni me sugjerime.

A. Shërbimet e ofruara në institucion

70% e stafit administrativ janë të kënaqur me ambientin dhe hapësirat e ofruara në punë, 18% janë pjesërisht të kënaqur dhe 9% nuk janë aspak të kënaqur.

Për 73% të anëtarëve të stafit administrativ, kushtet higjieno-sanitare janë të kënaqshme ose plotësisht të kënaqshme, dhe për 27% të anëtarëve janë pjesërisht të kënaqshme. Asnjë anëtarët nuk shpreh pakënaqësi totale me kushtet higjieno-sanitare.

Shërbimet e ofruara në lidhje me sistemin e sigurisë janë në nivele të kënaqshme përkatësisht për 45% dhe 36% dhe në mënyrë të pjesshme për 18% të pjesëmarrësve.

Shërbimet teknologjike dhe sistemi informativ BIS janë të kënaqshme përkatësisht për 27% dhe 18%, pjesërisht për 45% dhe 36%, ndërkohë që aspak të kënaqur janë 18%.

55% e stafit mendojnë se janë të informuar në lidhje me zhvillimet në institucion dhe 27% mendojnë se informimi është i pjesshëm. Për sa i takon kohës së informimit, 18% mendojnë se informimi bëhet në kohë, 45% janë të mendimit se informimi bëhet pjesërisht në kohën e duhur, 18% mendojnë se informimi nuk bëhet në kohën e duhur.

80% (8) pjesëmarrës janë të kënaqur me ushqimin e ofruar dhe pjesa tjetër (18% ose 3) janë pjesërisht të kënaqur me këtë shërbim.

Si përfundim, pjesa më e madhe e stafit është në përgjithësi e kënaqur me shërbimet e ofruara, kryesisht me kushtet higjieno-sanitare dhe ushqimin. Nuk ka asnjë shërbim ndaj të cilit të ketë pakënaqësi totale. Shërbimi që mund të merret në konsideratë për përmirësim është përmirësimi i shërbimeve teknologjike.

B. Bashkëpunimi në departament dhe në institucion

Lidhur me bashkëpunimin midis njësive dhe zyrave dhe fakultetit 72% dhe 36% e anëtarëve stafit administrativ janë pjesërisht të kënaqur, 45% dhe 18% e anëtarëve janë të kënaqur ndërsa 18% dhe 10% anëtarëve të stafit nuk janë të kënaqur.

55% e stafit administrativ mendojnë se në departament ekziston fryma e bashkëpunimit dhe 45% mendojnë se ekziston pjesërisht fryma e bashkëpunimit.

Edhe në lidhje me bashkëpunimin midis stafit akademik dhe administrativ rezultojnë se pjesëmarrësit janë të plotësisht të kënaqur (10%) ose të kënaqur (54%), dhe 36% janë pjesërisht të kënaqur. Kjo mbështetet edhe nga përgjigjet për pohimin se institucioni promovon frymën e bashkëpunimit ku pjesëmarrësit shprehen se janë plotësisht dakord ose dakord.

Për sa i përket sugjerimeve midis stafit administrativ, 45% mendojnë se sugjerimet e tyre merren parasysh nga pjesa tjetër e stafit, 35% mendojnë se sugjerimet e tyre merren parasysh pjesërisht, 20% mendojnë se sugjerimet e tyre nuk merren parasysh.

Si përfundim, mund të thuhet se në institucion promovohet fryma e bashkëpunimit, por pritshmëritë e një pjese të anëtarëve të stafit administrativ nuk përputhen plotësisht me politikën institucionale. Për të rritur përfshirjen e stafit administrativ, mund t'i mëshohet më shumë rëndësi marrjes parasysh së sugjerimeve të tyre nëpërmjet takimeve apo diskutimeve të herëpashershme.

C. Politikat dhe menaxhimi i institucionit

Për sa i përket, menaxhimit dhe drejtimit të institucionit, lehtësisë në përcjelljen e ankesave dhe mbështetjen e ideve inovative, rreth 50-54% shprehen të kënaqur dhe vetëm 27-18% e pjesëmarrësve shprehen pjesërisht të kënaqur, ndërsa 10-18% nuk janë të kënaqur dhe aspak të kënaqur janë 9-10% e pjesëmarrësve.

63% e stafit administrativ mendojnë se ankesat merren parasysh nga organet e prokurorisë, 10% e pjesëmarrësve mendojnë pjesërisht dhe 27% mendojnë se ankesat e tyre nuk merren parasysh.

Lidhur me përfshirjen në vendim-marrje të stafit administrativ 45% mendojnë se janë të përfshirë, 18 % mendojnë se janë pjesërisht të përfshirë ndërsa 12% mendojnë se nuk janë të përfshirë.

54 % e pjesëmarrësve janë të kënaqur me politikën dhe mbarëvajtjen institucionale, 18% janë pjesërisht të kënaqur, 10% nuk janë të kënaqur dhe 10% nga anëtarët e stafit nuk janë aspak të kënaqur me politikën institucionale.

Edhe në lidhje me mbështetjen e mendimeve inovative dhe prurjeve të reja, 45% e stafit administrativ janë të kënaqur, 36% janë pjesërisht të kënaqur dhe 18% nuk janë të kënaqur.

45% e pjesëmarrësve mendojnë se trajtimi i stafit bëhet në mënyrë të barabartë, 27% mendojnë pjesërisht, 18 % dhe 10% mendojnë se trajtimi i stafit nuk bëhet në mënyrë të barabartë.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë dakord se studentët përbëjnë përparësi për institucionin dhe marrëdhëniet mes stafit administrativ dhe studentëve janë të kënaqshme vetëm 18% e tyre janë pjesërisht dakord.

Për sa i përket mundësisë për zhvillimin profesional vihet re raporti me 18% (2) të kënaqur, 27% (3) pjesërisht të kënaqur, 45% (5) jo të kënaqur dhe 9% (1) aspak të kënaqur.

Në lidhje me nxitjen e stafit për kërkimin shkencor dhe praktikave profesionale 45% dhe 36% të pjesëmarrësve janë të kënaqur ndërsa 18% nuk janë aspak të kënaqur.

Për sa i përket ndërkombëtarizimit dhe programeve të shkëmbimit pjesa më e madhe e pjesëmarrësve (80) janë të kënaqur ndërsa 20 % nuk mendon se institucioni bën mjaftueshëm për ndërkombëtarizimin apo përfshirjen në programe shkëmbimi.

Si përfundim, me përjashtim të një pjese të vogël, pjesëmarrësit mendojnë se në përgjithësi menaxhimi dhe drejtimi i institucionit është në nivele të kënaqshme. Mund të shihen mundësitë për promovimin më shumë të kërkimit shkencor, zhvillimit profesional dhe programeve të shkëmbimit.

D. Ngarkesa dhe vlerësimi i punës

Pyetja në lidhje me ngarkesën në punë është me larmishmëri përgjigjesh. Ndërkohë që 36% mendojnë se ngarkesa e tyre është e përballueshme, 54% mendojnë se ajo është pjesërisht e përballueshme dhe 9% mendojnë se kanë ngarkesë jo shumë të përballueshme. Në lidhje me vlerësimin për punën që bëjnë, 30% ndihen të vlerësuar, 50% disi të vlerësuar dhe 20% nuk ndihen të vlerësuar për punën që bëjnë.

Në total, 70% e pjesëmarrësve janë të kënaqur që punojnë në KU Bedër dhe 30 % janë disi të kënaqur për këtë.